

SHTOJCA II

KONTRATË TIP **PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË LIDHUR ME** **PESHKIMIN NDËRMJET INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR SHËRBIMET E** **PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS DHE NJËSISË SË VETËQEVERISJES** **VENDORE**

Kjo kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Neni 1 **Palët**

Palët në këtë kontratë janë:

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës,

- _____, identifikuar me NIPT _____, me adresë në _____, përfaqësuar nga _____.

Neni 2 **Qëllimi i kontratës**

Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i menaxhimit të

_____ (infrastrukturës së lidhur me peshkimin) tek njësia e vetëqeverisjes vendore, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e veprimtarive, të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 3 **Kohëzgjatja**

Kjo kontratë ndërmjet palëve të lartpërmendura lidhet për një afat prej _____ vjetësh, afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Territori i infrastrukturës së lidhur me peshkimin që transferohet në menaxhim

1. Objektet që transferohen në menaxhim identifikohen me genplanin, që i bashkëlidhet kontratës dhe dokumentacionin e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
2. Pala, që merr në menaxhim, detyrohet të ruajë ambientet që merr në menaxhim.

Neni 5

Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik

Njësia e vetëqeverisjes vendore, gjatë menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin zbaton kushtet e parashikuara në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, duke garantuar:

- a) mosndryshimin e destinacionit dhe qëllimit;
- b) përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana institucioneve shtetërore në rastet e masave të jashtëzakonshme ose sa herë i kërkohet;
- c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;
- ç) ruajtjen dhe rritjen vlerës ekonomike të strukturave portuale të peshkimit që i janë transferuar për menaxhim, duke riparuar dhe përmirësuar infrastrukturën ekzistuese, në funksion të peshkimit.

Neni 6

Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr përsipër përballimin e kostove të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e saj.
2. Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të administrojë infrastrukturën e lidhur me peshkimin në mënyrë racionale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi për të nxitur mbrojtjen e mjedisit dhe një zhvillim të qëndrueshëm.
3. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për sigurinë dhe sigurimin në territorin që ka në menaxhim.
4. Çdo investim i kryer në infrastrukturë pavarësisht nga vlera duhet të marrë më parë miratim nga institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.
5. Njësia e vetëqeverisjes vendore detyrohet të raportojë çdo 6 muaj pranë institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe për akuakulturën lidhur me zbatimin e planit të menaxhimit, të shoqëruar me dokumentacion përkatës provues.
6. Njësia e vetëqeverisjes vendore detyrohet të depozitojë në çdo kohë çdo informacion të kërkuar, si dhe të krijojë akses për inspektimin e dokumentacionit teknik e financiar.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës

1. Në përfundim të vitit të parë të zbatimit të Kontrates, në varësi të performancës së njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe efektivitetit ekonomik, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, nëse vlerëson se kjo formë menaxhimi e infrastrukturës, nuk është efektive, ka të drejtë të zgjidhe në mënyrë të njëanshme Kontraten. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës nuk mban përgjegjësi ligjore, përfshirë edhe përgjegjësi financiare, ndaj palës.

2. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës detyrohet të kontrollojë/mbikqyrë infrastrukturën e transferuar, dokumentacionin dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe të kontratës.

Neni 8 **Mbikëqyrja**

Njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të krijojë të gjitha kushtet për mbikqyrjen nga ana e organeve shtetërore, të ngarkuara nga ligji, të infrastrukturës së lidhur me peshkimin, që ajo administron.

Neni 9 **Dokumentacioni**

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe njësia e vetëqeverisjes vendore kryejnë inventarin e infrastrukturës së peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, të cilin e merr në ngarkim së bashku me dokumentacionet përkatëse.

Neni 10 **Mbarimi i kontratës**

1. Kjo kontratë mbaron kur përfundon afati i përcaktuar në nenin 3 të saj;
2. Kjo kontratë mbaron para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj:
 - a) njësia e vetëqeverisjes vendore nuk kryen menaxhimin sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë;
 - b) njësia e vetëqeverisjes vendore shkel parashikimet e ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar ose kur ndryshohet destinacioni për të cilin është kryer transferimi;
 - c) kur nuk përmbushen detyrimet sipas planit të menaxhimit, mbi të cilin është kryer transferimi.
 - ç) me mirëkuptim mes palëve.

Neni 11 **Rinovimi i kontratës**

Me kërkesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe me miratimin paraprak nga ministri, kontrata mund të rinovohet, nëse insitucioni përgjegjës për peshkimin dhe akukulturën nëpërmjet njësisë së monitorimit ka konstatuar një menaxhim më efektiv të saj dhe realizimin e plotë të kushteve të kësaj kontrate.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët respektojnë legjislacionin në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet, të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të saj, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Nëse palët nuk zgjidhin mosmarrëveshjet, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
4. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është gjykata administrative.

Neni 13

Të ndryshme

1. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga 2 për secilën palë.
2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate duhet të negociohet ndërmjet palëve dhe të bëhet me shkrim.

PALËT NËNSHKRUESE

SHTOJCA III

KONTRATË TIP PËR TRANSFERIMIN E MENAXHIMIT TË INFRASTRUKTURËS LIDHUR ME PESHKIMIN NDËRMJET INSTITUCIONIT PËRGJEGJËS PËR SHËRBIMET E PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS DHE SUBJEKTEVE PRIVATE

Kjo kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Palët në këtë kontratë janë:

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, përfaqësuar nga Z. _____ me detyrë _____, në institucionin përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, i datëlindjes _____._____._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare, i pajisur me letër njoftimin nr. ____, që më poshtë do të quhet “QIRADHËNËSI”

Dhe

_____ me seli qendrore në _____, me adresë, _____ regjistruar si person fizik/juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: _____, përfaqësuar nga Z. _____, i biri i _____, i datëlindjes _____._____._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet “QIRAMARRËSI”.

Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës, mbështetur në vendimin nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave “_____”, pas konkurrimit të zhvilluar më datë _____._____._____, në zbatim të Vendimit nr. _____, datë _____._____._____ të komisionit, shpalli fitues _____.

Palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira “_____”, sipas dokumentacionit teknik, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në përdorim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për _____.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë _____ vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

1. “Qiradhënësi”, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, objektin e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto.
2. “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.
3. “Qiradhënësi” ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.
4. “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë objekt.
5. “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.
6. “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi objektin.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

1. “Qiramarrësi” ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë objektin e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
2. “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.
3. “Qiramarrësi” detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan e menaxhimit e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.
4. “Qiramarrësi” detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.
5. “Qiramarrësi” detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.
6. “Qiramarrësi” detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.
7. “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë objektin të padëmtuar.
8. “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga objekti, por pa dëmtuar atë.
9. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të kryera nga “Qiramarrësi”, dhe që nuk mund të hiqen nga objekti pa dëmtuar atë. Këto investime i kalojnë qiradhënësit në pronësi, pa kundër shpërblim.

10. Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha detyrimet që rëndojnë mbi objektin e dhënë me qira.

11. “Qiramarrësit” nuk i lejohet, që objektin e dhënë me qira ta japë me nën qira.

Neni 6

Ruajtja e destinacionit dhe e interesit publik

Qiramarrësi, gjatë menaxhimit të infrastrukturës së lidhur me peshkimin garanton:

- a) mosndryshimin e destinacionit dhe qëllimit;
- b) përdorimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana institucioneve shtetërore në rastet e masave të jashtëzakonshme ose sa herë i kërkohet;
- c) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik;
- ç) ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të infrastrukturës që i është transferuar për menaxhim, duke riparuar dhe përmirësuar infrastrukturën ekzistuese, në funksion të peshkimit.

Neni 7

Pagesa e qirasë

1. “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën _____.
2. Para nënshkrimit të kontratës “Qiramarrësi” paguan garancinë e kontratës, në _____ lekë, sipas faturës së lëshuar nga “Qiradhënësi”, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në plan biznes.
3. Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penaltete ose gjoba, “Qiramarrësi” do të likuideojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit” sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.
2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:
 - a) me pëlqim midis palëve.
 - b) kur objekti dëmtohet tërësisht për shkak të një force madhore.
 - c) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.
 - d) kur objekti prishet për interes publik.
 - e) çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 2 të këtij neni dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim. Në rast reagimi me shkrim nga “Qiramarrësi”, “qiradhënësi”, vlerëson argumentet e paraqitura dhe me pas merr vendimin përfundimtar.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

1. Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.
2. Palët janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës.

3. Me “Forcë Madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.
4. “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimin të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me kontratë me shkrim midis palëve.

Neni 10

Dispozitat e fundit

1. Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës kompetente.

Kjo kontratë është hartuar në 4 kopje origjinale.

QIRADHËNËSI

QIRAMARRËSI